



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.290, datë 23.09.2021

**“MBI VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS TË KANDIDATES
PËR T’U PRANUAR NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR
TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, PËR
VITIN AKADEMIK 2021-2022
ZNJ. BRISELDA ZHUZHI**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 1, të nenit 159, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 32, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, germa “a”, të pikës 8, të Seksionit Ç, të Kreut VI, të Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, e ndryshuar, e miratuar me Vendimin nr. 171, datë 27.9.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe pasi u njoh me Relacionin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale “Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës të znj. Briselda Zhuzhi, kandidate për t’u pranuar në programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2021-2022”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të konsiderojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës të kandidates znj. Briselda Zhuzhi për t’u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, në vitin akademik 2021-2022, sipas Relacionit bashkëlidhur.
2. Lejimin e kandidates znj. Briselda Zhuzhi për t’u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, në vitin akademik 2021-2022.
3. Të njoftohet për këtë vendim znj. Briselda Zhuzhi dhe Shkolla e Magjistraturës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
GENT I BRAHIMI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA



**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR
ELOIDA GOXHI**

**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**

**ANËTAR
MOISI DUDA**

**ANËTAR
VATË STAKA**

**ANËTAR
SANDËR BECI**

**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**